



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	17-08	3	viti Qëllim vitet
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SANSHUK	5702/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.868/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.868/2023 të datës 20.06.2023 të parashtruar nga ankuesi dhe ankesën me numër A.nr.865/2023 të datës 19.06.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër institucionit punëdhënës/Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Anullohet Raporti i Punës 05/2023 i Komisionit të Ristrukturimit lidhur me procedurën e transferimit në pozitën "Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes", Vendimi DM 194/2023 i datës 23.05.2023 dhe Vendimi DM 193/2023 i datës 23.05.2023 të nxjerra nga Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje*.

II. Detyrohet Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr veprimet juridike me qëllim të rishqyrtimit të kësaj lënde.

III. Obligohet Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (tutje AKP), me datë 20.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokolli:4844/2023 nën shenjën A.nr.868/2023, kundër Vendimit DM 194/2023 të datës 23.05.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ankesë e cila është plotësuar përmes shkresës të datës 16.08.2022.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se me rastin e zhvillimit të procedurës së transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit, Komisioni i ristrukturimi ka zbatuar gabimisht dispozitat e Udhëzuesit Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit, kanë shkelur dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil dhe kanë konstatuar gabimisht gjendjen faktike, sikurse për të njëjtë arsye vlerëson se edhe Vendimi i datës 23.05.2023 i Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit është i paligjshëm ngase për bazë ka pasur Raportin 05/2023 të Komisionit të Ristrukturimit, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e ankuesit, të anulojë vendimin e ankimuar dhe ta detyroi AKP-në që të bëjë sistemimin e ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Po ashtu, ankuesi i punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, më datë 19.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4826/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit DM 193/2023 i datës 23.05.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ankesë e cila është plotësuar përmes shkresës të datës 16.08.2022, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit material dhe të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil dhe konstatimit të gabuar të gjendjes së fakteve me theks të veçantë se poentimi lidhur me kalkulimin e përvojës së punës është bërë në kundërshtim me Udhëzuesin Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 26.06.2023 dhe datë 21.07.2023 ankesat e ankuesve i ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa Këshilli më datë 03.07.2023 dhe 27.07.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës. Po ashtu AKP sipas kërkesës ka përcjellë prova shtesë përmes shkresë së datës 08.08.2023 me shifër:2586.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 25.07.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin VK/2023 me numër:5347/2023 përmes së cilit ankesës së ankuesit ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune, po ashtu sipas kërkesës së Kryetares së Kolegjit, me datë 28.07.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin VK/2023 me numër:5436 përmes së cilit ankesës së ankuesit ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kryetari i Këshillit pas kërkesë për bashkim të lëndëve të Kryetares së Kolegjit në ankesën A.nr.865/2023, ka vendosur përmes Vendimit VK/2023 të datës 03.08.2023 që ankesa A.nr. 865/2023 e datës 19.06.2023 të bashkohet me ankesën A.nr.866/2023 e datës 20.06.2023 meqenëse objekti i shqyrtimit, baza ligjore dhe gjendja faktike ishte e njëjtë, ngase kishte të bënte me ristrukturimin e institucionit punëdhënës, proces ky në të cilën ankuesit pretendonin se u janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të shqyrtimit të ankesave të bashkuara ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokoli 4844/2023 e datës 20.06.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të parashtruar nga ankuesi; Vendimin DM 194/2023 të datës 23.05.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Raport Pune 05/2023 i Komisionit të Ristrukturimit me tabelat e poentimit; E-mailin e ankuesit të datës 08.06.2023 dërguar për L.Xh-T me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; E-mailin e ankuesit të datës 08.06.2023 dërguar për A.L me korrespondencën e bashkangjitur prej katër (4) faqesh; Tabela e pikëzimit lidhur me vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për nëpunësin A.F; Tabela e pikëzimit lidhur me vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për nëpunësin R.Z; Tabela e pikëzimit lidhur me vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për nëpunësin L.G; Diplomën e datës 16.11.2010 me Nr.28/10; Diplomën e lëshuar nga Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara -Universiteti i Prishtinës të datës 21.09.2007; Licencën e datës 07.06.2021; Vërtetimin e lëshuar nga ShKÇAK e muajit korrik 2010; Çertifikatën me shifër 1095504; Shkresën e lëshuar nga Hunter Institute of Technology me shifër student No:259926963; Diplomën e datës 25.05.2007; Çertifikatën e lëshuar nga UNMIK për ankuesin; Çertifikatën e lëshuar nga Qeveria e Kosovës e datës 07.11.2017; Çertifikatë e lëshuar nga M'S të datës 24.11.2004; Çertifikatë e lëshuar nga OSBE e datës 16.04.2004; Çertifikatë e lëshuar nga UNMIK EU PIPILLAR; Çertifikatë e lëshuar nga DFC e datës 10.06.2002; Çertifikatë e lëshuar nga DFC e datës 16.05.2002; Çertifikatë e lëshuar nga DFC e datës 20.03.2002; Falënderimin e lëshuar nga Komuna e Kaçanikut për ankuesin; Çertifikatë e datës 08.10.1999; Çertifikatën e datës 26.04.2001; Shkresë e lëshuar nga ARC-Kosova për ankuesin; Shkresën e 05.06.2008; Vërtetimin mbi përvojën e punës e datës 18.01.2022 lëshuar nga AKP; Kërkesën për përgjigje në e-mail të datës 26.06.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 03.06.2023; E-mailin njoftues të datës 21.06.2022; Vendimin e datës 31.10.2022 me shifër Nr.Ref.BD-171-61 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së; Shkresën e datës 15.11.2022 të Auditorit të Përgjithshëm; Vendimin e datës 30.11.2022 me shifër Nr.Ref.BD-171-61 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së; E-mailin njoftues të datës 06.12.2022; Organogramin e Strukturës Organizative të AKP-së të datës 25.04.2019; Akt emërimit e ankuesit 29.12.2022 me përshkrimin e detyrave të punës; Vendimi për Themelimin e Komisionit të Ristrukturimit i datës 14.12.2022; Vendimin e datës 14.02.2023 e Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së; Vendimi për Themelimin e Komisionit të Ristrukturimit i datës 12.05.2023; E-mailin njoftues të datës 22.12.2023; E-mailin e datës 23.12.2022 dërguar nga L.Xh-T për ankuesin; E-mailin e datës 19.01.2023 dërguar nga ankuesi për Njësinë e Burimeve Njerëzore; Vendimin DM 27/2023 të datës 06.02.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së me listën e pozitave sipas strukturës së re organizative; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes i datës 06.02.2023; E-mailin e datës 13.02.2023 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesin; Vendimin Nr.ref.BD-176/2 e datës 14.02.2023 Bordit të Drejtorëve; E-mailin e datës 14.02.2023 dhe 15.02.2023 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesin; Konkursin e datës 15.03.2023;

Kontratën e punës së ankuesit e datës 30.12.2010; Kontratën e punës së ankuesit e datës 28.11.2011; Kontratën e punës së ankuesit e datës 11.12.2009; Shkresën e personelit të datës 11.11.2009; Formularin e kërkesës për personel të datës 24.12.2010; Anex kontratë e datës 26.03.2009; Kontratën e punës së ankuesit e datës 06.02.2009; Kontratën e punës së ankuesit e datës 30.12.2008; Kontratën e punës së ankuesit e datës 28.10.2008; Kontratën e punës së ankuesit e datës 26.12.2012; Akt emërimit e ankuesit të datës 26.12.2012; Akt emërimit e ankuesit të datës 05.08.2014; Akt emërimit e ankuesit të datës 29.12.2022; Plotësim ndryshimin e Akt Emërimit të ankuesit datës 20.06.2023; Dokumentacionin e nëpunësit civil Diplomë e datës 02.10.2018 me numër:3545; Diplomën e datës 22.07.2004; Diplomën e datës 02.11.2006; Diplomën e datës 12.05.2009 me numër:121; Diplomën e datës 05.01.2005; Diplomën e datës 25.06.2005; Diplomën e datës 08.03.2006; Kontratën e punës të datës 04.02.2011; Kontratën e punës të datës 29.12.2010; Formularin e kërkesës për personel të datës 24.12.2010; Kontratën e punës të datës 11.12.2009; Shkresën e personelit të datës 11.11.2009; Kontratën e punës të datës 27.03.2009; Kontratën e punës të datës 28.12.2011; Deklaratën e datës 28.12.2011; Akt emërimit e datës 27.12.2012; Akt emërimit e datës 27.04.2015; Akt emërimit e datës 10.01.2023; Dokumentacionin e nëpunësit civil Lindirim Gashi-Diplomën e datës 24.01.2011 me numër:037/10; Diplomën e datës 10.06.2015 me numër:302/15; Kontratën e punës të datës 23.04.2012; Kontratën e punës të datës 28.12.2011; Deklaratën e datës 30.12.2011; Kontratën e punës të datës 29.12.2010; Formularin e kërkesës për personel të datës 24.10.2010; Kontratën e punës të datës 30.09.2010; Formularin e kërkesës për personel e datës 16.08.2010; Kontratën e punës të datës 28.12.2011; Akt emërimit e datës 27.12.2012; Akt emërimit e datës 18.07.2014; Akt emërimit e datës 24.08.2017; Akt emërimit e datës 11.09.2018; Akt emërimit e datës 28.12.2022; Çertifikatën e lëshuar nga CEED Kosovo; Dokumentacionin e nëpunësit civil Arian Fiqi-Diplomë e datës 05.09.2010 me numër:535/10; Diplomën e datës 19.05.2021 me numër:41/21; Kontratën e punës të datës 30.12.2010; Formularin e kërkesës së personelit të datës 24.12.2010; Kontratën e punës të datës 11.12.2009; Shkresën e personelit të datës 11.11.2009; Kontratën e punës të datës 16.10.2009; Akt emërimit e ankuesit të datës 30.12.2011; Deklaratën e datës 30.12.2011; Akt emërimi e datës 30.12.2022; Akt emërimit e datës 30.07.2014; Akt emërimit e datës 10.07.2017; Akt emërimit e datës 30.12.2022; E-mailin e datës 03.05.2023 dërguar nga L.Xh-T dërguar për DMZP-në; E-mailin e datës 08.05.2023 dërguar nga DMZP për Njësinë e Burimeve Njerëzore të AKP-së me listën e pozitave të lira të pozitave drejtues në kuadër të Shërbimit Civil; E-mailin e datës 24.05.2023 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të AKP-së për DMZP-në me listën e stafit për transferim të datës 22.05.2023; Vendimin e datës 26.05.2022 të Komisionit Disiplinor të AKP-së; Vendimin e Këshillit A.nr.539/2022 të datës 15.08.2022; Ankesën e ankuesit me numër protokoli 4826/2023 të datës 19.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin e punës me numër 05/2023 të datës të Komisionit të Ristrukturimit; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për ankuesin; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për ankuesin-Vjetërsia e nëpunësit civil në shërbimin civil për ankuesin; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për ankuesin-Kualifikimi profesional për ankuesin; Vendimin nën shenjen DM 193/2023 të datës 23.05.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 31.05.2023 nga Drejtori Menaxhues; Vendimin me Nr.705/2022 të datës 29.04.2022 të Sekretares së Përgjithshme të MPB-së; Udhëzuesin Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit; Certifikatat e ankuesit të bashkangjitura në shkresat e lëndës; Diplomën e ankuesit me Nr.3545 të datës 02.10.2018 nga

Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Ekonomik; Vërtetimin e punësimit me Nr.1023 të datës 21.03.2023 për ankuesin nga AKP-ja; Përshkrimin e punës për pozitën Drejtor i departamentit të shitjes; Vendimin me numër A.nr.451/2023 të datës 18.04.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër të referencës RN00011161 të datës 15.03.2023; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin L.G; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.07.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 27.07.2023 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin me Nr.Ref.BD-173/3 të datës 30.11.2022 nga Zëvendës Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve të AKP-së; Organogramin e AKP-së; E-mailin zyrtar të datës 06.12.2022 nga AKP për gjithë stafin; Akt emërimit e ankuesit me reference 172/DSH 1 të datës 10.01.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i departamentit të shitjes; Vendimin DM 1118/2022 të datës 14.12.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Vendimin DM 37/2023 të datës 14.02.202 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Vendimin DM 184/2023 të datës 12.05.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; E-mailin zyrtar të datës 22.12.2022 E-mailin zyrtar të datës 06.12.2022 nga AKP për gjithë stafin; E-mailin zyrtar të datës 23.12.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesin; E-mailin zyrtar të datës 23.01.2023 nga ankuesi për Burimet Njerëzore; Vendimin DM 27/2023 të datës 06.02.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i departamentit të realizimit të aseteve dhe shpërndarjes të datës 06.02.2023; E-mailin zyrtar të datës 13.02.2023 nga Burimet Njerëzore për nëpunësit e AKP-së; Vendimin Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 nga Zëvendës Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve të AKP-së; E-mailin zyrtar të datës 15.02.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesin; E-mailin zyrtar të datës 15.03.2023 nga AKP për gjithë stafin; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin M.A; Tabelat për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin M.A lidhur me vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; Tabelat për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin A.F; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin L.G; Dosjen e kandidatit M.A së bashku me shkresat e bashkangjitura lidhur me përvojën e punës, atë profesionale dhe trajnimeve dhe atë: Diplomën nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara për vitin akademik 2004/05; Licencën me Nr.01/2021 të datës 07.06.2021 për Ushtrimin e funksionit të administratorit falimentues nga Ministria e Drejtësisë; Certifikatat e trajnimeve të bashkangjitura sikurse në shkresat e lëndës; Diplomën me Nr.28/10 të datës 16.11.2010 të lëshuar nga Universiteti Mbretëror Iliria-Fakulteti i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë; Kontratën e punësimit të datës 30.12.2010 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 28.01.2011 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 22.12.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 11.11.2009 tek AKP; Kontratën e punësimit të datës 22.04.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 06.02.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 24.12.2009 tek AKP; Kontratën e punësimit të datës 08.01.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 28.10.2008 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 22.06.2012 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Akt emërimit me nume reference 188/DL 1 të datës 26.12.2012; Akt emërimit me nume reference 213/DKL 1 të datës 05.08.2014; Akt emërimit me nume reference 137/DKL 1 të datës 28.12.2022; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit me numër 26/ZDM-L 1 të datës 20.06.2023; Dosjen e ankuesit R.Z së

bashku me shkresat e bashkangjitura lidhur me përvojën e punës, atë profesionale dhe trajnimeve dhe atë: Kontratën e punësimit të datës 07.02.2011 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 28.01.2011 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 11.12.2010; Kontratën e punësimit të datës 23.12.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 11.12.2009; Kontratën e punësimit të datës 27.03.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 28.12.2011 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Deklaratën e datës 28.12.2011; Akt emërimit me numër reference 223/DSH 1 të datës 27.12.2012; Akt emërimit me numër reference 174/DSH 1 të datës 27.04.2015; Akt emërimit me numër reference 172/DSH 1 të datës 10.01.2023; Dosjen e kandidatit L.G së bashku me shkresat e bashkangjitura lidhur me përvojën e punës, atë profesionale dhe trajnimeve dhe atë: Diplomën me Nr.037/10 të datës 24.01.2011 të lëshuar nga Kolegji Victory; Diplomën me Nr.302/15 të datës 11.06.2015 të lëshuar nga Kolegji Victory; Kontratën e punësimit të datës 23.04.2012 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 28.12.2011 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Deklaratën e datës 30.12.2011; Kontratën e punësimit të datës 29.12.2010 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 24.12.2010; Kontratën e punësimit të datës 29.12.2010 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 16.08.2010; Kontratën e punësimit të datës 28.12.2011 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Deklaratën e datës 30.12.2011; Akt emërimit me numër reference 252/DSH 23 të datës 27.12.2012; Akt emërimit me numër reference 178/DSH 23 të datës 01.08.2014; Akt emërimit me numër reference 57/DSH 6 të datës 24.08.2017; Akt emërimit me numër reference 37/DKP 1 të datës 06.09.2018; Akt emërimit me numër reference 54/DKP 1 të datës 28.12.2022; Certifikatën e trajnimit të bashkangjitur sikurse në shkresat e lëndës tek CEED; Dosjen e kandidatit A.F së bashku me shkresat e bashkangjitura lidhur me përvojën e punës, atë profesionale dhe trajnimeve dhe atë: Diplomën me Nr.535/10 të datës 05.09.2010 të lëshuar nga Universiteti AAB; Diplomën me Nr.41/21 të datës 19.05.2021 të lëshuar nga Kolegji Iliria; Kontratën e punësimit të datës 30.12.2010 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 23.12.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 11.11.2009; Kontratën e punësimit të datës 19.10.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Akt emërimit me numër reference 243/DSH 21 të datës 30.12.2011; Deklaratën e datës 30.12.2011; Akt emërimit me numër reference 152/DMMPI 1 të datës 30.12.2022; Akt emërimit me numër reference 231/DVSH 5 të datës 30.07.2014; Akt emërimit me numër reference 48/DMMPI 7 të datës 10.07.2017; Propozimin me Nr.KR/23 të datës 22.05.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore e AKP-së; E-mailin zyrtar të datës 08.05.2023 nga DMZP për Njësinë e Burimeve Njerëzore të AKP-së; Tabela me listat e lira të nivelit të mesëm drejtues (ZKM, Ministrinë dhe Agjencionet); E-mailin zyrtar të datës 24.05.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të AKP-së për A.L; E-mailin zyrtar të datës 16.05.2023 nga DMZP për Njësinë e Burimeve Njerëzore të AKP-së si dhe E-mailat zyrtar të datës 05.06.2023 ndërmjet Njësisë së Burimeve Njerëzore dhe DMZP-së; Shkresë e datës 08.08.2023 me shifër:2586 prej 554 faqesh; Plotësimi i ankesës së ankuesit M.A e datës 16.08.2023 dhe plotësimi i ankesës së ankuesit Ramë Zagragaj e datës 16.08.2023; Vendimi i Kryetarit të Këshillit i datës 25.07.2023, Vendimi i Kryetarit të Këshillit i datës 28.07.2023 dhe Vendimi i Kryetarit të Këshillit i datës 03.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* tek organi i njëjtë, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me Vendimin me Nr.Ref.BD-173/3 të datës 30.11.2022 ka aprovuar Rregulloren Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe si rezultat i kësaj ka pasur shuarje të disa pozitive dhe ndryshime në përshkrimin e vendeve të punës të disa pozitive, ndërsa përmes Vendimit DM 1118/2022 të datës 14.12.2022 Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të çdo nëpunësi civil si pasojë e miratimit të Rregullores se re, kurse sipas Vendimit DM37/2023 të datës 14.02.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore është ndryshuar Vendimi DM 1118/2022 i datës 14.12.2022 lidhur me ndryshimin e njërës nga anëtarët e Komisionit të Ristrukturimit.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore më datë 23.12.2022 e ka njoftuar ankuesin që me rastin e miratimit të Rregullores Nr.07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është shuar Departamenti i Likuidimit, si rrjedhojë është shuar edhe pozita e punës "Drejtor i Departamenti i Likuidimit" të cilën ankuesi ka qenë duke e ushtruar sipas Akt Emërimit me numër reference:137/DKL1 të datës 29.12.2022, duke e njoftuar që Komisioni i Ristrukturimit konform dispozitave ligjore në fuqi do të trajtojë mundësinë e sistemimit në një pozitë të lirë ekzistuese.

Po ashtu, Drejtorja e Burimeve Njerëzore më datë 23.12.2022 e ka njoftuar ankuesin që me rastin e miratimit të Rregullores Nr.07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është shuar Departamenti i Shitjes, si rrjedhojë është shuar edhe pozita e punës "Drejtor i Departamenti të Shitjes" të cilën ankuesi ka qenë duke e ushtruar sipas Akt Emërimit me numër reference:172/DSH1 të datës 10.01.2023, duke e njoftuar që Komisioni i Ristrukturimit konform dispozitave ligjore në fuqi do të trajtojë mundësinë e sistemimit në një pozitë të lirë ekzistuese.

Nga shkresat e administruar të lëndës ndërlidhu me pretendimet ankimore të ankuesve, Kolegji i Këshillit ka gjetur se në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas Rregullores Nr.07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit përveç dy pozitive të lartcekura të cilat i mban ankuesit sipas akteve të emërimit, ishin shuar edhe dy pozita të tjera, respektivisht ishte shuar pozita "Drejtor i Marketingut, Marrëdhëniet me Publikun dhe Investitorët" si dhe pozita "Drejtor i Komisioneve Profesionale", kurse ishte krijuar një departament i ri, gjegjësisht pozita Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes, si rrjedhojë Institucioni punëdhënës ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuar të nenit 13 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil me rastin e përfshirjes së katër (zyrtarëve) në procesin e ristrukturimit të cilëve iu kishin shuar pozitat e punës me rastin e ndryshimit të strukturës organizative, ndërsa pozita e re e krijuar ishte ekuivalente apo e ngjashme me pozitat të cilat i kishin ushtruar sipas akteve të emërimit.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës respektivisht shkresës së titulluar Raport Pune 05/2023 e cila shkresë nuk mban datë të hartimit të saj nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, ka konstatuar se Komisioni i Ristrukturimit pas analizimit të dosjeve të ankuesve gjatë fazës së poentimit lidhur me kriteret e përcaktuara sikurse përcaktohet në paragrafin 5, nenit 14 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil si në vijim: "Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe

mbështetet mbi këto kriterë: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet” ka arritur në përfundimin se kandidatët të cilit i ishin nënshtruar procesit të transferimit me rastin e ristrukturimit të institucionit kishin arritur të grumbullonin pikët si në vijim: Nëpunësi civil A.F 35.5 pikë; Nëpunësi civil Ramë Zagragaj 34 pikë; Nëpunësi civil Muharrem Arifi 33.5 pikë si dhe Nëpunësi civil L.G 31.5 pikë, duke propozuar që kandidati me më së shumti pikë, respektivisht Nëpunësi Civil A.F duhet të transferohet në pozitën Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes.

Si rrjedhojë, pas përfundimit të Raportit të Punës 05/2023 nga ana e Komisionit të Ristrukturimit sipas të cilit ankuesit nuk kishin arritur pikë më shumë se kandidati tjetër në këtë procedurë, përmes Vendimit DM 194/2023 të datës 23.05.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit është njoftuar ankuesi se nuk kualifikohet për pozitën Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes, ndërsa nga data 01.06.2023 do të propozohet për transferim në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori në institucionin tjetër shtetëror, si dhe përmes Vendimit DM 193/2023 i datës 23.05.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit është njoftuar ankuesi se nuk kualifikohet për pozitën Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes, ndërsa nga data 01.06.2023 do të propozohet për transferim në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori në institucionin tjetër shtetëror.

Kolegji i Këshillit pas analizimit të formularëve të vlerësimit, respektivisht tabelave të poentimit për katër (4) zyrtarët e lartcekur në këtë procedurë të ristrukturimit lidhur me kalkulimin pikëve të mbështetur mbi kriterin e vjetërsisë së nëpunësit civil në shërbimin civil; vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë; kualifikimeve profesionale të nëpunësve civilë dhe trajnimeve, ka konstatuar se Komisioni i Ristrukturimit nuk ka zbatuar drejtë për secilin kriter apo ka zbatuar gabimisht formulat e përcaktuara të poentimit të përcaktuara me dispozitat e Udhëzuesit Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit respektivisht Shtojca Nr.1 lidhur me Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemi i Pikëzimit për Kriteret e Vlerësimit, nga del se pavarësisht faktit se Komisioni i Ristrukturimit në Raportin e Punës 05/2023 shprehimisht deklaroi se janë marrë përbazë çështjet e rregulluara me Udhëzuesin Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit, mirëpo rezultati final, mënyra e kalkulimit apo poentimi i kandidatëve shpërfaq një gjendje tjetër nga ajo që ky udhëzues e ka trajtuar dhe rregulluar, prandaj si i tillë Raporti i Punës 05/2023 i Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit është akt administrativ i paligjshëm sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”, ngase raportit në fjalë i mungon arsytimi apo arsytimi është i mangët dhe jo i plotë si dhe nuk përmbush kriteret e nevojshme të arsyeshmërisë sikurse përcaktohet me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative lidhur me shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të dosjes së kandidatëve dhe arsytën pse metodologjia e përdorur e poentimit është e zbatueshme në rrethanat e rastit konkret dhe mbi çfarë baze ligjore është bërë, andaj mbi këtë bazë Raporti i Punës 05/2023 i Komisionit të Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit lidhur me transferimin për pozitën Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes është shfuqizuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, si rrjedhojë janë shfuqizuar të

gjitha aktet e tjera juridike që ndërlidhen me këtë proces apo që rrjedhin nga ky raport, e në rrethanat e rastit konkret janë shfuqizuar Vendimi DM 194/2023 i datës 23.05.2023 dhe Vendimi DM 193/2023 i datës 23.05.2023 të nxjerra nga Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të cilat akte janë goditur me ankesat e ankuesve, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në fazën e poentimit të katër (4) kandidatëve në këtë procedurë të transferimit.

Prandaj, nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit thekson faktin se Komisioni i Ristrukturimit të AKP-së, me rastin e rishqyrtimit dhe rivendosjes në tërsi të lëndës që ndërlidhet me procesin e procedurës së transferimit lidhur me procesin e ristrukturimit të institucionit për pozitën Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes, duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme sipas dispozitave të ligjit material, Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Udhëzuesit Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të konstatimit të saktë të gjendjes faktike dhe poentimit të kandidatëve vetëm sikurse përcaktohet me rregullat dhe udhëzuesin në fuqi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.868/2023

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së